



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 723/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevc, duke vendosur lidhur me apelin e Subjektit Politik NISMA Socialdemokrate, dega në Podujevë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me numër Protokoli 2858/2021, të datës 28.10.2021, me objekt të çështjes keqpërdorimi i votave, për Zgjedhjet Lokale 2021, të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 31.10.2021, mori këtë:

### **V E N D I M**

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.723/2021 i datës 29.10.2021, i paraqitur nga Subjekti Politik NISMA Socialdemokrate, dega në Podujevë, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me numër Protokoli 2858/2021, të datës 28.10.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në të gjitha Qendrat e Votimit, në Komunën e Podujevës.

### **A r s y e t i m**

Me datë 29.10.2021, PZAP ka pranuar apelin Anr.723/2021, nga Subjekti Politik NISMA Socialdemokrate, dega në Podujevë, me të cilin pretendon se kanë dyshime të mëdha se votat për kandidat për kryetar në Komunën e Podujevës janë keqpërdorur nga komisionerët pothuaj se në të gjitha vendvotimet. Parashtruesi i ankesës shton se Subjekti Politik Nisma Socialdemokrate, nuk ka pasur komisioner në çdo vendvotim dhe se nga kjo arsye iu janë abuzuar votat e tyre, prandaj kërkojnë rinumërim të votave në gjitha vendvotimet Kërkojnë që fillimisht të numërohen votat e Subjektit Politik NISMA Socialdemokrate në QV 1818E, në Orllan, me qëllim që të vërtetohet dallimi i votave dhe pastaj të bëhet rinumërimi i të gjitha Vendvotimeve në Komunën e Podujevës.

Përgjigje në apel ka paraqitur KQZ, me të cilën thekson se pretendimet e palës ankuese lidhur me keqpërdorimin e votave të kandidatit për kryetar të Komunës së Podujevës, nga radhët e Subjektit Politik NISMA Socialdemokrate, janë të pabazuara në fakte dhe prova për ta dëshmuar atë se çfarë pretendon pala ankuese. Andaj, konsiderojnë se ankesa duhet të hudhët si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj apelin vlerësoi se:

## Apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtuesi i apelit kërkon që të rinumërohen votat në të gjitha Qendrat e Votimit në Komunën e Podujevës, ndërsa në raport me këto pretendime në apel nuk ka bashkangjitur asnjë provë për të dëshmuar se mbi cilat shkaqe e kërkon një gjë të tillë, pasi rinumërimi i votave për Subjektin Politik NISMA Socialdemokrate duhet të mbështetet në dëshmi të qarta për manipulime dhe keqpërdorime të votave me rastin e numërimit, e të cilat shkaqe parashtuesi i apelit ka dështuar që ti argumenton, prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, apelin e parashtuar e konsideron si të përgjithshëm dhe të pa bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117.3 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku barra e të provuarit bie mbi ankuesin.

Pretendimet e përgjithshme e të pa mbështetura në asnjë provë relevante si të tilla mbesin pretendime por qe ato si te tilla nuk mbështetën me asnjë prove, mbi bazën e të cilave PZAP-i, nuk mund të vendos ndryshe, përveç asaj që është vendosur në dispozitivin e këtij vendimi.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr. 723/2021 më datën 31.10.2021**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.